

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

30.06.2021
Ora 11:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, znj. Alketa Kico Basho”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**


2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëhere në seancën e sotme publike kemi 2 çështje në rendin e ditës. Pika e parë ka të bëjë me projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull” dhe pika e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull. Zoti sekretar i KQZ-së, relativimin?

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Dropull ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari i zonjës Maria Jovani, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues në listën shumemërore e Partisë Socialiste, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 19, zonja Alketa

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

Basho e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit me numër unik 2167. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se kandidatja për anëtar e Këshillit të Bashkisë Dropull ka ndryshuar mbiemrin nga "TARIFA" në "BASHO". Komisioni Qendror i zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, e cila në përgjigje të shkresës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk ka kthyer ende përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton e padënuar dhe pa shënime në sistem. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Dropull zonja Alketa Basho, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në pozicionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "n" dhe pika 2 dhe neni 164, pikat 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vendos:

Zonja Alketa Kiço Basho, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Dropull nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë së ushtrimit të funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, Zonja Alketa Kiço Basho.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja e tij në fuqi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.421

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

30.06.2021
Ora 11:08

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike:**

• **Z. Besnik Strati, avokat i Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, zotit Qerim Ismailaj.**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër. I Japim fjalën sekretarit për të relatuar në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, pastaj vazhdojmë me rradhë.

Z. Y. Merkaj: Më falni zoti Komisioner, por duhet të bëhet verifikimi i prezencës.

Z. I. Celibashi: Ju jeni kandidati? Ju jeni Kryetari i Bashkisë?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

Z. B. Strati, avokat: Unë i nderuar jam avokati.


Z. I. Celibashi: Keni prokurë?

Z. B. Strati, avokat: Kemi prokurë, po.

Z. I. Celibashi: Atëherë mund të vazhdojmë. Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka paraqitur prokurën e posaçme sipas së cilës përfaqësohet në këtë shqyrtim nga avokati Besnik Strati . Vazhdojmë me relatimin.

Z. Y. Merkaç: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit të disa subjekteve, ndër të cilët edhe Kryetari i Bashkisë. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Në zbatim të këtyre dispozitave zoti Qerim Ismailaj, kandidat për Kryetar i Bashkisë Mallakastër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, ka depozituar në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit me numër 2456 në datën 12.05.2019. Referuar të dhënave të deklaruara nga subjektet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimisht bën verifikimin paraprak të të gjitha të dhënave të deklaruara nga këto subjekte dhe konkretisht në datën 12.05.2019 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila në datën 14.05.2019 ka informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për Kryetar Bashkie, zoti Qerim Ismailaj nuk ka të regjistruar dënime penale të formës

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila deri në momentin e regjistrimit si kandidat nuk ka kthyer përgjigje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas përfundimit të verifikimeve paraprake, ka konstatuar se subjekti, zoti Qerim Ismailaj nuk ka pasqyruar ndonjë të dhënë, e cila i përket gjendjes së tij gjyqësore dhe duke marrë parasysh dhe përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku nuk rezulton të ketë dënime penale për këtë shtetas. Me vendimin nr. 438, datë 16.05.2019 ka regjistruar si kandidat për Kryetar të Bashkisë Mallakastër, zotin Qerim Ismailaj. Në përfundim të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 Qershor 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 ka miratuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 qershor 2019 sipas së cilit zoti Qerim Ismailaj u shpall fitues në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme datë 09.01.2020 është paraqitur një kërkesë nga subjekti politik Partia Demokratike, me objekt verifikimin e pastërtisë së figurës të shtetasit Qerim Ismailaj, në zbatim të përcaktimeve të nenit 7, pika 2 të ligjit 138 të vitit 2015. Gjithashtu në datën 13.01.2020, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të paraqesë formularin e vetëdeklarimit për këtë subjekt. Në datën 25.01.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka paraqitur formularin e deklarimit dhe materialet e kërkuara që dispononte pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme pas vlerësimit të kësaj çështjeje ka kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, pra në institucionet përgjegjëse brenda dhe jashtë vendit dhe në datën 14.06.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Qerim Ismailaj. Sipas dispozitivit të këtij vendimi të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk rezulton të

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

ketë gjeneralitete në Gjendjen Civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshuara nga të deklaruarat. Rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga autoriteti gjyqësor i huaj. Referuar vendimit nr. 9/11 të vitit 2000, të gjykatës të përbërë në betim të Kios në Greqi, i formës së prerë. Rezulton se i dënuari Qerim Ismailaj, në mungesë, në gjykim, është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 3 vjet burg, për veprën penale të konfliktit ose përleshjes, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë. Pjesë që i korespondon veprës penale të dënimit dhe të tjera me dashje të parashikuara nga neni 90/1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, e cila si sanksion parashikon dënimin vetëm me gjobë. Gjthashtu nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nuk rezulton të jetë nën hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale. Nuk rezulton të ketë qënë i dënuar apo arrestuar nga organe ligjzbatuese të huaja apo shqiptare për kryerjen e një vepre penale. Nuk rezulton të ketë qënë i siguruar me masë shtrënguese të sigurimit personal nga një autoritet shqiptar apo i huaj. Nuk rezulton dëbuar/deportuar nga ndonjë autoritet i huaj. Sipas këtij vendimi të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton e provuar që subjekti Qerim Ismail Ismailaj është dënuar në mungesë me 3 (tre) vjet burgim për kryerjen e veprës penale konflikt, të parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal Grek. Duke qënë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për shqyrtimin e të dhënave të paraqitura për të gjykuar nëse këto të dhëna përfshihen në fushën e ndalimeve të parashikuara nga ligji 138 i vitit 2015, po i paraqesim Komisionerit vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për këtë subjekt.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i subjektit, avokati?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021*

Z. B. Strati, avokat: Po i nderuar zoti kryetar. Në datën 30.06.2021 jemi njoftuar nga ana juaj përmes komunikimit elektronik për t'u paraqitur ditën e sotme në këtë seancë, në orën 11 përballë komisionit, për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin vetëdeklarues, zotin Qerim Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër. Po në datën 30.06.2021, në kushtet që vetëm në këtë ditë jam njoftuar dhe kam marrë dhe përfaqësimin me prokurë, për të ushtruar një mbrojtje efektive në kushte të ngutshme. Pavarësisht se kam bërë edhe një kërkesë pranë Prokurorisë së Përgjithshme për vënien në dispozicion të dokumentacionit verifikues, do të kërkoja nga ana juaj të merrej parasysh kërkesa për një seancë tjetër dëgjimore, pasi kërkoja të bëja një mbrojtje sa më efektive, duke paraqitur provat si formë e kërkuar nga ligji, nga ana e subjektit. Kam një kërkesë me shkrim.

Z. I. Celibashi: Doni që ta shtyjme?

Z. B. Strati, avokat: kërkoj kohë për të paraqitur mbrojtjen me shkrim. Është një afat shumë i shkurtër. Mundësisht edhe një ditë, më mjafton sa për të marrë..., Nëqoftëse ju e vlerësoni?

Z. I. Celibashi: Mirë dakord, do t'a pranojmë kërkesën tuaj. Vetëm këtë kërkesë kishit? Për shtyrjen e seancës.

Z. B. Strati, avokat: Vetëm këtë kërkesë, për shtyrje. Do të na jepej mundësia të merreshin dokumente...

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2021**

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë do t'a lëmë të premtën, pasnesër, dakord? Të premtën në orën 11, jemi dakord?

Z. B. Strati, avokat: Dakord!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit, seanca mbyllet.

Z. B. Strati, avokat: Faleminderit!



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

02.07.2021
Ora 11:10

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues zoti Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, B.Kodra**
- **Parti Politike: PD (I.Kaso)**
- **Z. Besnik Strati, avokat i Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, zotit Qerim Ismailaj.**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë fillojmë sot seancën publike për vazhdimin e shqyrtimit të çështjes që ka të bëjë me verifikimin e thelluar të Kryetarit të Bashkisë së Mallakastrës. Present sot në këtë seancë janë, përfaqësuesi i subjektit të verifikimit, avokati..,

Z. B. Strati: Besnik Strati, present.

Z. I. Celibashi: ..dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike në cilësinë e subjektit të interesuar në këtë shqyrtim. Arëhere, relatimin nga ana e administrates së

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me këtë çështje ne e kemi bërë. Nuk e di nëse përpara se të vazhdojmë me procedurën më tej, kemi ndonjë kërkesë tjetër paraprake?

Z. B. Strati: Jo i nderuar nuk kemi.

Z. I. Celibashi: Nuk keni. Dakord, fjalën po ia jap përfaqësuesit të Partisë Demokratike si objekti i interesuar në këtë shqyrtim dhe më pas përfaqësuesit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, faleminderit.

Z. I. Kaso: Faleminderit i nderuar zoti Kryetar! Jemi në këtë shqyrtim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu siç është relatuar nga ana juaj por edhe edhe nga administrata në cilësinë e personit të interesuar, pasi ka qenë forca jonë politike që e ka vënë në lëvizje verifikimin e thelluar për këtë të zgjedhur vendor, konkretisht të Njësisë së Qeverisjes Vendore të Mallakastrës, për arsye që sipas informacioneve që ne kemi disponuar dhe që tashmë u vërtetuan nëpërmjet rrugëve zyrtare dhe procedurave që ligji i dekriminalizimit parashikon. Ka qenë në kushtet e pazgjedhshmërisë në momentin që ka kandiduar, pasi ka qenë në kushtet e ndalimit sipas dispozitave specifike të këtij ligji. Konkretisht ashtu siç verifikohet edhe nga përgjigjet që autoritetet greke i kanë nisur Prokurorisë së Përgjithshme, e cila e ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për efekt të këtij procedimi, më rezulton se personi në fjalë është i dënuar për një veprë penale, në mos gaboj me 3 (tre) vite heqje lirie. Në këto kushte vlerësojmë se ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa “ç” e ligjit të dekriminalizimit, i cili parashikon konkretisht që ndodhen në kushtet e ndalimit të kandidimit personat të cilët janë dënuar për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe kur janë dënuar

*Zbardhi materialin audio
Artinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

me jo më pak se 6 (gjashtë) muaj burgim. Masa e dënimit në shtetin grek e këtij shtetasi bie brenda parashikimeve të kësaj pike, pra është dënuar me më shumë se 6 (gjashtë) muaj burgim. Në këto kushte personi gjendet në pamundësi për të kandiduar për një periudhë 10 vjeçare, periudhë e cila fillon nga data e vuajtjes së dënimit dhe përfundon me skadimin e afatit 10 vjeçar. Nga informacionet që disponojmë, të plota në këtë dosje, rezultojnë që vuajtja e dënimit ende nuk ka filluar për këtë person, pasi ky person me dashje i është shmangur vuajtjes së dënimit. Në këto kushte ndodhet ende sot që flasim në periudhë ndalimi të kandidimit dhe në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'a konstatojë këtë fakt juridik të pamohueshëm dhe rrjedhimisht të aplikojë sanksionin ligjor që është ai i shkarkimit të tij. Ne vlerësojmë se përgjigja që ka sjellë Prokuroria e Përgjithshme është e detajuar, por jepen informacione që nuk janë në dobi të këtij hetimi dhe të këtij shqyrtimi pasi i referohet edhe konvertimit të veprës penale në bazë të legjislacionit shqiptar. Ne vlerësojmë që ky operacion do të ishte i dobishëm dhe i domosdoshëm për persona që ndodheshin në kushtet e ndalimit sipas shkronjave "a" dhe "b" të po këtij neni dhe të po kësaj pike, pra të pikës 1 të nenit 2 dhe nuk aplikohet në persona që janë në kushte të ndalimit sipas shkronjës "ç". Pra, në këndvështrimin e legjislatorit, personat që gjenden në kushtet e ndalimit sipas shkronjës "ç" është irrilevante se si konvertohet vepra penale për të cilën jam dënuar më shumë se 6 (gjashtë) muaj burgim në një shtet tjetër. Se si konvertohet kjo në legjislacionin shqiptar. Në këto kushte vlerësoj se ajo që duhet të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është vetëm të konstatojë faktet, nëqoftëse personi është dënuar me më shumë se 6 (gjashtë) muaj, dhe është dënuar, nëqoftëse personi e ka vuajtur dënimin, pra për të përlogaritur periudhën në të cilën nuk i lejohet të kandidojë dhe është fakt i pamohueshëm që nuk ka filluar ende t'a vuajë dënimin. Pra, afati 10 (dhjetë) vjeçar është ende për të filluar dhe rrjedhimisht të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

konstatojë pasojën e vetme ligjore që rrjesh nga verifikimi i këtyre dy fakteve juridike, që është ajo e pamundësisë së tij për të kandiduar në momentin që ka kandiduar, është zgjedhur dhe ka marrë mandatin. Kaq për sa i përket çështjes i nderuar. Kërkojmë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpresojmë që Komisioneri në këtë rast do t'i konstatojë këto fakte dhe do të vendosë ndërprerjen e menjëhershme të mandatit të këtij të zgjedhuri vendor, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Atëherë fjalën ia japim përfaqësuesit të subjektit të verifikimit, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, po fjala është për ju.

Z. B. Strati, avokat: Po i nderuar Kryetar. Në aspektin procedural në datën 29.06.2021 ne jemi njoftuar nga ana juaj përmes komunikimit elektronik për paraqitjen në seancë me datën 30.06.2021 në orën 11:00 përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në një seancë publike, për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vëtedeklarues zoti Qerim Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur që emërohen dhe ushtrojnë funksione publike". Jua sjellim në vemendje fillimisht se subjektit apriori i janë shkelur parimet e së drejtës së informimit, referuar parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, gjatë kohës së hetimit administrativ pasi nuk ka pasur asnjë lloj informacioni, prandaj dhe në seancën e kaluar ne kemi kërkuar të ngjitemi me provat e letrës, të cilat ishin verifikuar nga ana e prokurorisë. Mbase kemi bërë kërkesë, nga vetë subjekti, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, gjithashtu dhe pranë organit tuaj, KQZ-së. Mbase jemi njohur me dokumentet na janë vënë në dispozicion aktet, kemi filluar mbrojtjen e subjektit. Fakti, Subjekti Qerim Ismailaj aktualisht ushtron detyren e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier. Bazuar në parashikimet e dispozitave të Ligjit 138/2015 ky shetas me

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

ushtrimin e funksionit të tij rezulton të jetë subjekti vetëdeklarues në kuptim të ligjit. Referuar vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, që ndodhen në dosje, rezulton se në datë 09.01.2020 është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme kërkesa e kërkuesit Partia Demokratike, për “Verifikimin e pastërtisë së figurës të zotit Qerim Ismailaj”. Mbi bazë të kësaj këkese, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer hetimet për verifikimin e subjektit vetëdeklarues dhe në datën 14.06.2021 Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin deklarues Qerim Ismailaj, me funksion kryetar i Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

- a. Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përberësit e gjendjes civile të padeklaruara ose te ndryshme nga ato të deklaruara:
- b. Rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, nga autoriteti gjyqësor i huaj, referuar Vendimit 9-11/2000 të gjykatës së përbërë nga hetimi në ishullin Chios, e formës së prerë , rezulton se i akuzuari në mungesë është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 3 vite burg për veprën penale “ Konflikti ”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës ë Greqisë, që i korespondon veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje” parashikuar nga neni 90 paragrafi i parë i kodit të Republikës së Shqipërisë, e cila sanksionon dhe parashikon dënimin vetëm me gjobë.
- c. Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- d. Nuk rezulton të jetë në hetim apo gjykim.
- e. Nuk rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organe ligjzbatuese të huaja apo shqiptare, për kryerjen e nje vepre penale.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

- f. Nuk rezultoi i siguruar me masë shtrënguese të sigurimit personal nga një autoritet shqiptar apo i huaj
- g. Nuk rezultoi të jëtë lëshuar ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale
- h. Nuk rezultoi i dëbuar/deportuar nga një autoritet i huaj

Për sa i përket pretendimeve lidhur me procedurat e ndjekura nga Gjykata e Shkallës së Parë Kios, Greqi, provohet fakti se gjatë gjykimi ndaj këtij shtetasi, Qerim Ismailaj, është zhvilluar në mungesë të tij dhe nuk evidentohet nga autoritetet greke të drejtësisë që ai të ketë marrë dijeni për vendimin gjyqësor penal të dënimit në ngarkim të tij. Kjo gjë faktohet me prova bindese, ku nga ana e Prokurisë së Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën 396/1 protokollin datë 17.01.2020 ka paraqitur dokumentin e vërtetimit ligjor ku rezulton se shtetasi është i pa dënuar. Nga verifikimet e sistemit TIMS, rezulton se subjekti Qerim Ismailaj nuk figuron i ndaluar, arrestuar nga autoritete ligjzbatuese të huaja apo shqiptare për ndonjë vepër penale. Ky subjekt nuk rezulton person i dëbuar nga territori i ndonjë shteti. Gjithashtu dhe nuk ka asnjë urdhër kërkimi në ngarkim të tij. Me shkresën nr. 1284/1, protokoll datë 21.01.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Shtetit Shqiptar konstaton se Qerim Ismailaj nuk ka qenë i ndaluar apo arrestuar nga struktura e policisë së shtetit. Me shkresën nr. 1378/2 protokoll datë 05.02.2020 nga Zyra Qendrore Kombëtare e Interpolit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjithashtu nga informacionet e kryera në arkivën e zyrës dhe të sistemit të kërkimit të Interpolit nuk ka të dhëna deri më datën 03.02.2020 ndaj këtij shtetasi. Po kështu edhe nga kthimi i përgjigjes nga Interpoli i Athinës faktohet se për këtë shtetas nuk disponojnë rezultate të njohura në lidhje me përputhshmërin e shenjave të gishtave për këtë shtetas. Gjithashtu rezulton se nga korespondenca dhe sqarime të metejshme me organet përkatëse të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

shtetit Grek, rezulton se me dokumentin nr. 153/30.07.2020 Gjykata e Shkallës së Parë Kios nuk ishte e mundur hetimi i plotë dhe i gjendjes evidence e dorëzimit të vullnetit të saj për vendimin nr. 9, 10, 11/25.02.2020 të Gjykatës së përbërë ndaj të akuzuarit ndaj dhe nuk mund të ketë vërtetim për këtë vendim. Po kështu faktohet se ndaj shtetasit Qerim Ismaili nuk figuron te ketë ndonje masë sigurimi personal në shtetin Grek. Nga shpjegimet e dhëna nga autoritetet greke të drejtësisë, duke qenë se shtetasi Qerim Ismailaj në këtë konflikt ka qenë thjesht i përfshirë, por nuk ka dëmtuar askënd, përveç faktit që është dëmtuar rëndë si pasojë e dhunës së ushtruar nga persona të tjerë dhe në gjendje kome ka vazhduar mjekimin. Vepra penale “Konflikt”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal i Republikës së Greqisë për të cilën është dënuar, në mungesë, mund të gjejë zbatim me të vetmen dispozitë të Kodit Penal Shqiptar, atë të “Dëmtimeve të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 paragrafi i parë i Kodit Penal. Dispozita e cila parashikon se rrahja si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet vetëm me gjobë. Duke patur parasysh parashikimet e kësaj vepre në kuptim të anës objektive të saj faktohet dhe në materialin e Prokurorisë së Përgjithshme se subjekti ka qenë në kushte shtrimi spitalor dhe i është nënshtruar ndërhyrjes kirurgjikale në gjendje kome, ç’ka do të thotë se nga ana e subjektit që po hetoni administrativisht është shkelur dhe shkaktuar dhunë dhe është subjekt i dëmtuar dhe jo personi që ka shkaktuar nje vepër penale. Theksojmë se subjekti është viktimë e veprës penale dhe jo personi autor i veprës, ndaj nuk ka logjike fakti i pretenduar se është autor i një vepre penale. Me rëndesi thelbesore eshte fakti se subjekti nuk ka marrë asnjehere dijeni në raport me gjykimin që është zhvilluar duke mos patur mundësi efektive për të ushtruar një mbrojtjen e tij duke i mohuar kështu garancitë bazë të Kodit të Procedurës Penale si subjekt. Ky pretendim faktohet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Athinë me Vendimin nr. 99/2020 ku konfirmohet

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

fakti se në rastin në gjykim në Gjykatën Penale në Kios, ky vendim u dha në mungesë të të pandehurit, pa rezultuar kur i ishte dhënë dhe gjithashtu nuk ishte e mundur të gjendej prova e dorëzimit të këtij vendimi të pandehurit që mungonte. Kjo në kuptim të dispozitave Proceduriale Penale të çon para fakti se personit ndaj të cilit i atribuohet një veprë penale duhet që të marrë dijëni dhe duhet paraqitur fakt dhe të dhëna të mjaftueshme për marrjen e cilësisë së të pandehurit, gjë që duhet të zbatohet nga ana e prokurorisë apo nga ana e gjykatës së shtetit grek. Pretendim ky se subjekti është dënuar në këto kushte pranueshmërie mungese dhe mos pasje dijëni për të ushtruar mbrojtjen efektive, përbën pavlefshmeri absolute edhe në kuptim të dispozitave procedurale të legjislacionit tonë penal. Në lidhje me parashikimet e Ligjit 138/2015 për të argumentuar ligjërisht nëse jemi në cënim ose jo te kushteve te përcaktimeve ligjore të nenit “Për garantimin dhe integritetit të personave që zgjidhen dhe emërohen” duam të theksojmë: Së pari, lidhur me caktimin e dënimit ndaj shtetasit nga leximi i kësaj dispozite dhe qëllimi që ligjvënësi ka patur në raport me këte veprë penale, kjo parashikon Nenin 2 të Ligjit nr. 138/2015 “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”. Provojmë se ndodhemi përpara rastit kur, pavarësisht se dënimi nga gjykata greke është dhënë me burgim, ai është i pazbatueshëm për sa i takon llojit të dënimit (me burg), pasi Neni 90 paragrafi i parë i Kodit Penal Shqiptar sa sqaruam me sipër parashikon dënim vetëm me gjobë dhe në këto kushte, nuk mund të tejkalohet kufiri maksimal i dënimit për veprën penale që parashikon të njëjtin fakt, për të cilin personi është dënuar nga një gjykatë e huaj aq më tepër në kushte padijënie. Në këtë këndvështrim dënimi i vetëm që mund t’i jepet nga gjykata shqiptare në një rast, do të vihej në ekzekutim, është vetëm detyrimi me gjobë. Referuar vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Sektorit të Dekriminalizimit, e cila referon se përsa i përket faktit nëse vepra për të cilën është dënuar subjekti


*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

deklarues dhe masa e dënimit duhet të përfshihet ose jo në kufizimet e parashikimit të Ligji nr. 138 provohet se vetë ligjvënësi e ka parashikuar se cilat dispozita përkatëse çënojnë pozitën e kandidatit të zgjedhur për pengimin e ushtrimit të detyrës. Së dyti, subjekti gjatë gjithë këtyre viteve ka patur hyrje dhe dalje të shumta në shtetin grek dhe nuk ka qenë ndonjëherë person i ndaluar për t'u përgjigjur për veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe për ekzekutimin e këtij vendimi, pasi vetë shteti grek siç përshkruhet në materialet të cilat i janë përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, nuk ka patur asnjë shkak të ligjit për të ushtruar ndjekje, pasi subjekti dhe gjendja është konsideruar në mungesë, dënim. Gjithashtu gjatë gjithë periudhës njëzet vjeçare, duke qenë se vetë subjekti ka të afërmit e vet në shtetin grek, aq më shumë me ishullin ku ka ndodhur kjo ngjarje, duke vajtur, duke patur shumë hyrje-dalje, në asnjë moment nuk i është ndaluar nga autoritetet greke për t'ju vënë në dijeni apo për t'u ekzekutuar ky vendim penal. Së treti, referuar kërkuesit se subjekti ka qenë i arrestuar dhe i ndaluar në Greqi në vitin 1999-2000 dhe është arrestuar. Është i pavërtetë dhe kjo provohet nga konkluzionet e vetë prokurorisë si dhe po kështu provojmë se në këtë periudhë subjekti Qerim Ismailaj ushtronte efektivisht detyrën e mësuesit të Histori-Gjeografisë për vitin arsimor 1999-2000. Fakt për të cilin paraqesim në cilësinë e provës "Vërtetimin e Sigurimeve Shoqërore" si dhe borderotë e kësaj periudhe se subjekti ka qenë i punësuar dhe i siguruar në shtetin shqiptar në profesionin e mësuesit pranë Komunës Kutë dhe Fshatin Corush. Fakt që edhe njëherë vërteton padijeninë e subjektit mbi dënimin në mungesë në shtetin grek. Një fakt tjetër që kundërshton pretendimin e kërkuesit përse i përket dijenisë së subjektit lidhur me dënimin nga shteti grek është edhe pasaporta e subjektit që jua sjellim në cilësinë e provës, ku nga sistemi TIMS vërtetohet që dhe ditën që subjekti ka bërë kallëzimin, ka qenë për një periudhë 4 ditore në shtetin grek dhe përsëri nuk është


*Zbardi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

ndaluar apo informuar përsa i përket këtij vendimi penal. Referuar formularit të vetdeklarimit ku subjekti ka shprehur vullnetin e tij plotësuar në datën 11.05.2019, referur të dhënave që kërkohen në këtë formular përsa i takon gjendjes gjyqësore. Kjo provohet me prova bindëse se subjekti nuk ka shkelur asnjë nga parashikimet që ligjvënësi ka marrë parasysh në rastin e subjekteve që zgjidhen dhe emërohen në pozicione të tilla në zbatim të Ligjit rr. 138/2015. Konkretisht Subjekti nuk ka qenë në dijeni të dënimit të tij me vendim të formës së prerë nga një autoritet shqiptar apo i huaj. Po kështu subjekti nuk është në dijeni nëse është dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtare nga një autoritet i huaj apo shqiptar për çështje penale të pazgjidhura me vendim të formës së prerë. Fakti që subjekti nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga autoritetet provohet pasi nuk ka asnjë dokument apo regjistër që të pasqyrojë këtë fakt nga një shtet i huaj, siç është shteti grek. Subjekti nuk ka qenë asnjëherë i arrestuar nga ndonjë organ ligjzbatues sa kohë që pranohet se s'ka patur asnjë masë sigurie personale qoftë gjatë ngjarjes së pretenduar, qoftë dhe më pas kur ka patur hyrje dhe dalje në shtetin grek. Subjekti nuk ka qenë njoftuar ndonjëherë ndaj tij urdhëri për kërkim ndërkombëtar. Në këto kushte të gjitha parashikimet që ligjvënësi ka patur në konsideratë që do të përbënin cënim për pozitën e zgjedhjes së subjekteve kandidate nuk plotësohen duke ligjëruar kështu pretendimin e subjektit kërkues për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe pabazueshmërinë e pretendimit të kërkuesit të cilin e referojnë tek parashikimet ligjore "Për ndalimin për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik" sipas nenit 2. Sqarojme se në Nenin 2 pika "c" dhe pika "ç" e këtij neni, argumente tek të cilat është mbështetur kërkuesi, lexuar në interpretim autentik si dhe literalisht, ligjvënësi ka parashikuar se nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë apo kryetarë bashkie në çdo rast nuk mund të marrin një funksion personat të cilët janë dënuar me jo më pak se 2 (dy) vjet apo

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

dhe 6 (gjashtë) muaj burgim. Pra, edhe nëse qëndrojmë në logjikën e vetë ligjit dhe shkakut përse është iniciuar kjo kërkesë ndaj subjektit, tërësia e veprimeve të kryera nuk konsiderohet krim por kundravajtje. Ndaj, nuk bën pjesë në asnjë parashikim të ligjit, e atillë që subjekti të mund të vetëdeklaronte diçka për të cilën ka një tërësi provash bindëse që nuk ka patur dijëni dhe se është viktimë e veprës penale. Nëse subjekti vetëdeklarues do të kishte dijëni, do t'a kishte deklaruar absolutisht këtë veprim në vetëdeklarim dhe normale dhe do të mbante përgjegjësi. Në këto kushte nuk ka asnjë bazë shkakut që kërkuesit dhe akuza që bëhet ndaj subjektit që po hetoni administrativisht. Kjo krahasuar me garancitë që bëjnë ndaj subjektit që po hetoni administrativisht. Kjo krahasuar me garancitë që vetë ligji paska parashikuar në konsideratë për moslejimin e vijimit të ushtrimit të funksionit. Subjekti nuk ka patur asnjë interes për të fshehur deklarin e tij, sa kohë që provohet edhe nga vetë hetimi që nuk ka patur dijëni për gjykimin që zhvillohej ndaj tij si dhe për faktin që theksuam me sipër se është alogjike që të dënohet një person që është dhe viktimë. Po kështu duke patur parasysh shkaqet diskriminuese si dhe mosrespektimin e parashikimeve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, vlerësojmë se ky subjekt hyn në rangun e atyre shqiptarëve, të cilët kanë punuar në shtetin grek dhe që standarti i garantimit të të drejtave kushtetuese është cënuar në mënyrë të hapur, siç është dhe rasti objekt shqyrtimi. Në lidhje me këto rrethana janë mbajtur edhe raporte të shumta nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, raporte të aksesueshme publike ku evidentohen shkeljet e emigrantëve shqiptarë në kushtet e mosvënies në dijëni për hetime, gjykime, fajësi apo mosdhënie shërbimi avokator dhe mosvënie në ndihmë të përkthyesit. Nëse vlerësohen me objektivitet kriteret e ligjit në raport me deklarin e parashikon formulari i vetëdeklarimit, provohet se subjekti nuk ka qenë në dijëni të dënimit të tij me vendim të formës së prerë nga një autoritet shqiptar apo i huaj. Nuk është në

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

dijeni nëse është dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet i huaj. Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim apo në gjykim nga autoritetet dhe kjo provohet nga dokumente të cilat vihen në dispozicion. Në përfundim kërkojmë që nga ana juaj si komision të vlerësohen në tërësi materialet e vendosura në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe provat shtesë nga subjekti që provojnë të kundërtën e pretendimit të kërkuarit dhe të mbahet një qëndrim objektiv ndaj këtij qëndrimi dhe qëllimi i vlerësimit të drejtë të pozitës së subjektit. Kërkojmë nga ana juaj vijimin e ushtrimit të funksionit të detyrës së subjektit vetëdeklarues. Bashkangjitur po ju sjell dhe provat, të cilat i kemi në formën e kërkuar nga ligji. Një dëshmi penaliteti nga shteti grek ku vërtetohet se është i padënuar. Vërtetimin e sigurimeve shoqërore 1999-2000, ka qenë i punësuar në listën e pagesave si dhe një kopje të pasaportës nga sistemi TIMS, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, kemi ndonjë shtesë, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

Z. I. Kaso: Faleminderit i nderuar! Shumë shkurt për atë çfarë relatoi avokati dhe një pjesë e fashikullit jo detyrimisht vjen në kundërshtim me këtë që kemi thënë ne dhe me sa parashtruam. Ajo çfarë ne parashtruam dhe i qëndrojmë është që interpretimi që Prokuroria e Përgjithshme bën në shkresë në lidhje me konvertimin e veprës, ka vend vetëm në ndalimet e parashikuara nga shkronja "a" dhe shkronja "b", të cilët bëjnë fjalë për veprat e kategorisë dhe ndalimet sipas veprave penale dhe është logjike që një krim ose vepër e kryer në një shtet të huaj, sigurisht që do të shihet, nëqoftëse përkthehet në kategorinë e veprave në shkronjat "a" dhe "b" ndalojnë. Shkronja "ç" dhe shkronja "c" nuk kanë të bëjnë me llojin e veprës dhe prandaj dhe operacioni që prokuroria ka kryer në shkresën që i kthen përgjigje

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i pavlerë në këndvështrimin tonë për efekt të këtij shqyrtimi, pasi ndalimi ka të bëjë me çfarëdolloj vepre që të jetë kryer në shtetin e huaj, mjafton që të jetë dënuar me më shumë se 2 (dy) vjet burg, në rastin e shkronjës “c” dhe me shumë se 6 (gjashtë) muaj burg në rastin e shkronjës “ç”. Për këtë arsye ne vlerësojmë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri në këtë rast, në zgjidhjen e kësaj çështjeje, nuk duhet të mbajë parasysh atë pjesë të interpretimit që Prokuroria e Përgjithshme ka bërë dhe zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë shtesë, koment? Për t’a mbyllur këtu, përfaqësuesi i Kryetarit të Bashkisë?

Z. B. Strati, avokat: Po i nderuar. Periudha e ndalimit të kandidimit për personat që parashikohet në shkronjën “ç” pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, ndalimin në çast, në momentin e përfundimit dhe një nga kushtet kryesore është deri në momentin e reabilitimit. Nga viti 2000, jemi sot 2021, 21 vjet, një person duhet të vazhdojë akoma i dënuar sipas pretendimeve? Kemi Institutin e Reabilitimit. Është parashtruar vepra, është parashtruar dhe dënimi.


Z. I. Celibashi: Falemionderit, kishit disa prova për të dorëzuar?

Z. B. Strati, avokat: Po.

Z. I. Celibashi: Atëherë, përpara se t’a përfundojmë shqyrtimin dhe hetimin administrativ. Prova, diskutime të tjera, pretendime të tjera nuk keni?!

Z. B. Strati, avokat: Jo nuk kemi.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

Z. I. Celibashi: Edhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike... Mirë atëherë konsiderojmë të mbyllur proceduralisht hetimin administrativ dhe duke qenë se nuk e shoh të nevojshme të marr kohë për të dhënë një vendim në lidhje me këtë çështje, pasi në vlerësimin tim është e qartë. Kjo edhe pas diskutimeve dhe pretendimeve të parashtruara nga secila prej palëve të interesuara në këtë proces. Po konkludoj në lidhje me çështjen fillimisht nëpërmjet një arsytimi të shkurtër në lidhje me vendimin që do të marr. Si qëndron kjo çështje në vlerësimin, arsyetimin e Komisionerit?! Çështja është e thjeshtë në fakt dhe thelbi i çështjes është pikërisht ajo çfarë solli në vëmendje dhe pretendoi përfaqësuesi i Partisë Demokratike, sipas së cilit nëse jam i qartë në citim apo në përkthim të asaj çfarë u tha nga ana e tij. “Pavarësisht së çfarë veprë penale ka kryer subjekti i verifikimit, fakti që masa e dënimit të tij, e dhënë kjo edhe nga një autoritet gjyqësor i huaj është mbi masën e dënimit që ka përcaktuar neni 2, pika 1, shkronja “c”. Mjafton kaq dhe vetëm, ai është në kushtet e ndalimit”. Unë mendoj që ky pretendim, në vlerësimin tim dhe interpretim të ligjit nuk qëndron. Neni 2 i ligjit ka përcaktuar në tërësinë e vet rastet e ndalimit të ushtrimit të një funksioni publik. Ka përcaktuar që për disa kategori veprash penale, pavarësisht masës së dënimit, ekziston ky ndalim. Pra, ky është rregulli i përgjithshëm dhe në plotësim të këtij rregulli apo në përjashtim të këtij rregulli, edhe nëse vepra penale të cilën e ka kryer subjekti verifikues nuk përfshihet në kategorinë e atyre veprave penale për të cilat ai do të ndalohej që të kandidonte. Nëse ka një masë dënimi prej 2 vjet, krim, pra ka kryer një veprë penale të kategorizuar si krim dhe është dënuar, ka marrë një masë dënimi 2 vjet, atëherë do të ishte në kushtet e ndalimit. Ose plotësimi tjetër apo përjashtimi tjetër, pika “ç”, për kryerjen me dashje të një krimi që nuk parashikohet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, pra të pikës 1 dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim. Çfarë ndodh tani? Në rastin kur vendimet penale apo


*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

procedimet penale janë kryer nga autoritetet përkatëse, gjyqësore apo edhe ndjekjes penale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, konkretisht Komisioneri, sikurse janë dhe parashikimet e ligjit, bën vetë vlerësimin nëse subjekti është apo nuk është në kushtet e ndalimit. Duke lexuar aktin e autoritetit gjyqësor përkatës shqiptar dhe konkludon, sepse është thjesht një lexim i thjeshtë i vendimit përkatës të këtij autoriteti dhe të normës dhe shikon nëse vepra penale për të cilën ai është akuzuar dhe mandej dënuar përfshihet në kategorinë e veprave penale, që pavarësisht masës së dënimit, atij do t'i ndalohej ushtrimi i funksionit publik, e para. Nëse rezulton se nuk është në këtë kategori, shkon tek pika "c", pra nëse nuk është në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1. Më pas shkon tek shkronja "c", duke verifikuar nëse ka kryer krim dhe nëse ky krim nuk parashikohet në kategorinë e veprave penale të përcaktuara nga shkronjat "a" dhe "b", por, ka një masë dënimi mbi dy vjet. Nëse nuk është dhe ky rast, atëherë shkon tek germa "ç" dhe shikon nëse krimi është me dashje, nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1, të nenit 2, por është dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim. Pra ky është rasti klasik kur vendimi është i dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar. Çfarë ndodh nëse ky vendim nuk është dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar, por është dhënë nga një autoritet i huaj? Në këtë rast KQZ dhe Komisioneri nuk e ka mundësinë edhe ligji kështu e thotë, që t'a bëj këtë vlerësim, sepse KQZ nuk ka as kapacitetin dhe as kompetencën lëndore për të vlerësuar nëse një vepër penale e kryer në një territor të huaj, kualifikohet si një nga ato veprat penale, për të cilat ai do të ishte në kushtet e ndalimit. Çfarë ndodh? Atëherë ligji ka parashikuar detyrimin por dhe të drejtën e institucionit të KQZ-së për t'ia bërë këtë kërkesë organit të Prokurorisë. Është organi i Prokurorisë, i cili i thotë KQZ-së që vepra penale dhe çdo element tjetër i lidhur me këtë vepër penale të kryer, apo më mirë të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

themi veprim apo mosveprim, sepse mund të mos jetë edhe në kushtet e kryerjes së një vepre penale. Sa dhe si qëndron në ato që ka parashikuar neni 2. Pra, në këtë rast leximi i ligjit për dekriminalizimin dhe konstatimi i rasteve të përjashtimit nga ana e KQZ-së, nëse do të shpreheshim në mënyrë figurative, bëhet me syzet e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Pra, ai na thotë që çfarë vepre penale ka kryer. Ne shohim nëse kjo vepër penale, të cilën ai na thotë që e ka kryer, është apo nuk është vepër penale e cila e vendos në kushtet e ndalimit një subjekt. Është leximi nëpërmjet syzeve të tij të themi, edhe për rastin përjashtimor apo plotësues. Pra, në rastin konkret ne jemi duke lexuar një vendim, për ta thënë më qartë edhe në mënyrë ndoshta dhe më të kuptueshme dhe për një publik më të gjerë. Ne në rastin e leximit të opinionit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, kur bëhet fjalë për një vepër penale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është njësoj sikurse do të lexonim vendimin e një autoriteti gjyqësor apo procedural penal shqiptar. Çfarë na thotë ky lexim? Ky lexim na thotë që subjekti i verifikimit, në këtë rast Kryetari Bashkisë Mallakastër, ka kryer vepër penale të rrahjes dhe kjo vepër penale është dënuar ose do të duhet të ishte dënuar me gjobë. Pra, në këtë rast, në kushtet e këtij leximi për të cilin unë mendoj që Komisioneri nuk mund të bëjë lexim tjetër tej kësaj duke vlerësuar që, po kjo është vepra penale. Por kjo vepër penale nuk ka rëndësi sepse ne jemi para faktit që kemi një dënim 2 vjet. Në vlerësimin tim nuk ka kuptim të flasim për masë dënimi kur ndërkohë paraprakisht të shikojmë se çfarë vepre penale ai ka kryer. Por, në tërësi thjesht edhe në mënyrë të plotë, ne jemi para leximit të një vendimi të supozuar të dhënë nga një autoritet juridiksional shqiptar, sipas të cilit ne lexojmë që subjekti është dënuar për një kundërvajtje penale dhe masa e dënimit për këtë kundërvajtje penale është maksimalisht me gjobë. Për ta bërë dhe më të qartë argumentin dhe më bindës në vlerësimin tim, nëse subjekti do të kishte kërkuar kjo dhe sipas asaj çfarë thotë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.02.07.2021*

organi i Prokurorisë dhe do të kishin filluar procedurën e njohjes së këtij vendimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, ne do të ishim në këtë përfundim. Pra, do të kishim vendimin e një gjykate shqiptare që ka njohur vendimin e gjykatës greke dhe në njohje, në përfundim të këtij procesi njohje, ky person do të ishte dënuar për veprën penale të rrahjes dhe maksimalisht ky do të ishte dënuar me gjobë. Pra, nëse procesi i verifikimit, nëse janë kushtet e ndalimit, do të kryhej kur ky paraprakisht do të kishte filluar një procedurë njohje, atëherë do të ishte më e qartë akoma që ky person, ky subjekt nuk do të ishte në kushtet e ndalimit. Për ta konfiguruar ndoshta pak në mënyrë akoma dhe më të plotë çfarë do të ndodhte nëse për një moment KQZ do të vendoste sot dhe do ta konsideronte për shkak të vetë masës së dënimit pa e konsideruar natyrën e veprës penale ndalimin e këtij dhe ndërprerjen dhe eventualisht subjekti do të kërkonte njohjen e vendimit, ne do të ktheheshim përsëri te kjo pikë ku jemi sot në kuptim të argumentit që sapo thashë. Ndaj për ta përfunduar, bazuar dhe në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” vendos: Konstatimin se zoti Qerim Ismail Ismailaj Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr.138/2015. Vazhdimin e mandatit të zotit Qerim Ismail Ismailaj si Kryetar i Bashkisë Mallakastër Qarku Fier. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit, seanca mbyllet.

Vendimi nr.422

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

